

KMSHC mirëpret studentët në programet e praktikës mësimore dhe internshipit

Institucioni i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) ka nisur zbatimin e programeve të praktikës mësimore dhe internshipit, duke mirëpritur studentë nga universitetet kryesore në vend, si pjesë e angazhimit për të mbështetur formimin profesional të të rinjve dhe për të forcuar lidhjen mes institucioneve të arsimit të lartë dhe administratës publike.



Në kuadër të këtyre programeve, KMSHC ka pritur studentë nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, në degët: “Administratë Publike”, “Politikat e Integritit dhe Qeverisjes” dhe “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, si dhe studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, nga programi Master Profesional në Shkenca Politike.

Gjatë ditëve të para të angazhimit, studentët janë njohur nga afër me strukturën, funksionimin dhe rolin e institucionit në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil. Ata kanë zhvilluar takime prezantuese me stafin dhe drejtuesit e institucionit, duke u njohur me proceset kryesore të punës dhe sfidat e administratës publike.



Programet synojnë të ofrojnë një eksperiencë konkrete profesionale, duke ju dhënë mundësi studentëve të aplikojnë njohuritë teorike në praktikë, si dhe të zhvillojnë aftësi të rëndësishme për tregun e punës. Përmes bashkëbisedimeve dhe diskutimeve të hapura, studentët kanë pasur mundësi të adresojnë pyetje mbi funksionimin e shërbimit civil dhe perspektivat e tyre profesionale.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbetet i përkushtuar në promovimin e një administrate publike të bazuar në meritë, transparencë dhe ligjshmëri, si dhe në mbështetjen e brezit të ri të profesionistëve që do të kontribuojnë në zhvillimin institucional të vendit.

